# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5731
E enjte, 21 mars 2019
çmimi 0.40 €


## Veseli paralajmëron masa të ashpra ndaj korrupsionit dhe nepotizmit

FAQE 5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", REXHEP SELIMI FAQE 4-5

# Heqja e taksës do ta kthente Kosovën në pozicion edhe më të keq

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se taksa 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë duhet të qëndrojë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se heqja e kësaj mase do ta kthente Kosovën në pozicion edhe më të keq sesa që ishte në ditën kur nuk kishte taksë. Selimi ka theksuar se shpeshherë pyetet se a duhet të bjerë qeveria për shkak të taksës por, sipas tij, përgjigja është se ka arsye të tjera pse kjo qeveri duhet të bjerë. "Një ndër arsyet se përse Kosova duhet të shkojë drejt zgjedhjeve është keqqeverisja deri në degradim", ka thënë ai. Selimi ka pohuar se punësimet politike, familjare dhe klanore janë vetëm një nga arsyet e shumta që Kosova nuk e meriton të udhëhiqet nga qeveria aktuale. Në këtë intervistë Selimi ka folur edhe për Ligjin për dialogun me Serbinë, ku thotë se presin që Kushtetuesja ta marrë vendimin e drejtë në mbrojtje të sovranitetit të vendit

## ISA MUSTAFA NUK E MOHON KANDIDATURËN PËR KRYETAR TË LDK-së

Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, nuk e ka mohuar mundësinë e rikandidimit për kryetar të partisë edhe për një mandat tjetër. Ai ka thënë se për këtë çështje do të deklarohet kur të vijë koha, para mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor të LDK-së. Mustafa ka thënë se zyrtarisht deri më tani nuk ka asnjë kandidat për të parin e partisë. Sipas tij, LDK-ja është unike dhe ambicie për kryetar mund të ketë çdo njëri FAQE 3

## Karaxhiqi dënohet me burgim të përjetshëm

FAQE 3

## AKTUALE

### PËRBALLJA E ASAMBLESË PARLAMENTARE E KËSHILLIT TË EVROPËS ME RUSINË F. 11

Xhavit HALITI

### META PARALAJMËRON DORËHEQJEN NGA POSTI I PRESIDENTIT F. 2

### PETROVIQI SULMOHET NGA ZYRTARËT E LISTËS SERBE F. 6

## EKONOMI

### DOGANA BASTIS 32 LOKACIONE PËR LUFTIMIN E KONTRABANDËS F. 8

### BERZH-i NDAN 30 MILIONË EURO PËR PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME F. 9

## SPORT

### KOSOVA NDAJ DANIMARKËS PËR TA DËSHMUAR FORCËN F. 14

### DONJETA SADIKUT I MUNDËSOHET MARRJA E BURSËS OLIMPIKE 'TOKIO 2020' F. 14


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Pse e tërhoqi Trumpi kandidaten për ambasadore në Shqipëri?

**Tiranë, 20 mars** - "Presidenti amerikan Donald Trump e ka tërhequr nominimin e zyrtares së lartë, që pritej të konfirmohej si ambasadore e ShBA-së në Shqipëri", thotë gazetarja amerikane Sarah Carter, e cila pretendon se njeh edhe arsyen e kësaj lëvizjeje.

Carter ka folur për "Fox News", ndërsa e ka bërë publik informacionin edhe në profilin e vet në "Twitter". Duke cituar një zyrtar të Shtëpisë së Bardhë, në artikullin e saj reporterja shpjegon se Kathleen Ann Kavalec është emëruar përmes procesit të karrierës, por presidenti ia ka tërhequr nominimin.

Kavalec, nga sa pretendon ajo, duke cituar të njëjtin burim, nuk është në pritje në Senat dhe nuk është konfirmuar asnjëherë në këtë post. Gazetarja hulumtuese mendon se ka zbuluar shkakun e një vendimi të tillë. Sipas saj, zyrtarja e DASh-it ka komunikuar me ish-agjentin britanik Christopher Steele, i cili kishte hartuar një dosje me pretendime shkeljesh e komploti ndërmjet fushatës presidenciale të Trumpit dhe Moskës në zgjedhjet e vitit 2016. Carter thotë se kanë dalë në dritë informacione që tregojnë se Kavalec u takua personalisht dhe ka pasur komunikim të vazhdueshëm me Steele para dhe pas zgjedhjeve presidenciale. Ajo, po kështu, thekson se punonjësja veterane e dash-it, e cila ka punuar edhe për zëvendëssekretaren e Shtetit, Victoria Nuland, është mbështetëse e ish-presidentit Barack Obama dhe ish-kandidates demokrate në garën për Shtëpinë e Bardhë, Hillary Clinton, dhe se ka bërë për fushatat e secilit prej tyre nga një donacion të vogël prej 250 dollarësh.

Faqja e internetit e Departamentit të Shtetit, ndërkohë, vazhdon ta tregojë Kathleen Ann Kavalec si kandidate. Vetë kjo e fundit nuk iu është përgjigjur kërkesave për koment, të paraqitura në rrugë zyrtare.

# Karaxhiqi dënohet me burgim të përjetshëm

**Dhoma e Apelit e Mekanizmit që trashëgoi Gjykatën për Krime Lufte në Hapësirat e ish-Jugosllavisë ka hedhur poshtë ankesat e Radovan Karaxhiqit kundër dënimeve që i janë shqiptuar për gjenocid dhe krime të luftës në Bosnjë e Hercegovinë në vitet 1990. Atij i është zgjatur dënimi 40-vjeçar me burgim të përjetshëm**

**Prishtinë , 20 mars** - Gjykata Ndërkombëtare në Hagë ka kundërshtuar apelin e ish-liderit të serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq, kundër dënimeve që i janë shqiptuar për gjenocid dhe krime të luftës në Bosnjë e Hercegovinë në vitet 1990. Atij i është zgjatur dënimi 40-vjeçar me burgim të përjetshëm. Kjo është masa e fundit që është i shqiptuar Karaxhiqit për rolin e tij në masakrën në Srebrenicë më 1995, për orkestrimin e rrethimit gati katërvjeçar të Sarajevës dhe për krimet e kryera gjatë luftës në 20 komuna të Bosnjës. Për këto akuza ai ishte dënuar më 2016 me 40 vjet burgim.

Vendimi i ri për të është marrë më 20 mars nga Mekanizmi Ndërkombëtar për Tribunalet Penale, një gjykatë e Kombeve të Bashkuara, e cila merret me rastet që kanë mbetur të papërfunduara nga Tribunali Ndërkombëtar për krime në ish-Jugosllavi. Teksa ka lexuar apelet para gjykatës, gjyqtari Vagn Joensen ka thënë se Karaxhiqi ka dështuar që t'i hedhë poshtë vendimet e Tribunalit paraprak rreth qëllimit të tij për të kryer gjenocid. Joensen ka thënë se Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi ka vepruar drejt kur ka vërtetuar se Karaxhiqi ka qenë pjesëmarrës në masakrën e Srebrenicës, pasi ka qenë në kontakt të ngushtë me njerëzit që kanë qenë në ato zona.

Në këtë vend janë vrarë më shumë se 8 000 burra dhe djem myslimanë nga forcat serbe të Bonjës, për ta shënuar mizorinë

më të keqe në Evropë prej Luftës së Dytë Botërore. Ai ka thënë se Karaxhiqi nuk ka arritur të dëshmojë që gjykata ka gabuar kur ka vlerësuar se ai ka qenë fajtor për pjesëmarrje në terrorizimin e popullatës së Sarajevës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se dënimi me burgim të përjetshëm i Radovan Karaxhiqit është konfirmim se Serbia ishte agresorja e luftërave që përgjakën ish-Jugosllavinë. "Aktgjykimi përfundimtar i Tribunalit të Hagës, që dënon me burgim të përjetshëm Radovan Karaxhiqin për gjenocidin e kryer në Bosnjë e Hercegovinë, është satisfaksion moral për qindramijëra viktima të pafajshme. Njëkohësisht është konfirmim i faktit se Serbia ishte agresorja e luftërave që përgjakën ish-Jugosllavinë", ka thënë Veseli.

Ndërkaq zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se vendimi për dënimin me burgim të përjetshëm për Radovan Karaxhiqin është moment i rëndësishëm për viktimat e krimeve të orkestruara nga Beogradi. "Radovan Karaxhiqi pati rol kyç në gjenocidin e Serbisë kundër civilëve në Bosnjë dhe Hercegovinë, për çka u dënua sot me burgim të përjetshëm. Ky është moment shumë i rëndësishëm për të gjitha viktimat që sistematikisht kanë vuajtur nga krimet e orkestruara në Beograd", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Twitter".

# Meta paralajmëron dorëheqjen nga posti i presidentit

**Tiranë, 20 mars (ER)** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, gjatë një ndalese të mërkurën në Pogradec, ka folur për situatën politike në Shqipëri, duke paralajmëruar edhe dorëheqjen e tij nga posti i presidentit Ai ka thënë se është shumë i ndërgjegjshëm për rrënjët e kësaj krize. Meta ka thënë se për këtë situatë kritike në Shqipëri i ka paralajmëruar aktorët vendës dhe ndërkombëtarë prej kohësh, që situata mund të shkojë drejt zhvillimeve të paparashikuara. Ai ka theksuar se është e rëndësishme të evitohet çdo përshkallëzim i krizës, e cila mund të sjellë konfrontime. "Për këtë qëllim i ftoj të gjithë të mos sakrifikojnë vendin për karriget e tyre apo për ambiciet e veta", ka thënë ai.

Meta ka thënë se është i gatshëm që të sakrifikojë edhe vetë. "Në këtë drejtim, edhe pse nuk kam asnjë përgjegjësi për këtë situatë që është krijuar, edhe pse kam bërë çdo përpjekje prej gati dy vjetësh në këtë detyrë, për të parandaluar një situatë dhe një krizë të tillë, përsëri jam i gatshëm i pari të sakrifikoj në emër të një zgjidhjeje politike që rivendos normalitetin kushtetues, institucional, politik, demokratik në vend dhe që garanton ecjen e shpejtë drejt çeljes së negociatave në BE. Jam i gatshëm për të dyja ekstremet. Që nga dorëzimi i mandatit tim si president, pasi të sigurohem se vendi ka një zgjidhje politike parimore, kushtetuese, solide, që e çon përpara, e deri te sakrifikimi i jetës sime si Salvador Alende për ta ndaluar instalimin e një junte që mund ta kthente Shqipërinë 30 vjet pas", ka thënë Meta, duke shtuar se do t'i qëndrojë betimit të tij që, midis pushtetit dhe demokracisë, do të mbajë gjithmonë krahun e demokracisë.

"Vetëm demokracia garanton një pushtet për popullin shqiptar në mënyrë që ta ndalojmë shpopullimin e Shqipërisë", ka thënë presidenti Meta.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka mbajtur konferencë për medie pas takimit me kryetarët e degëve të partisë

# Isa Mustafa nuk e mohon kandidaturën për kryetar të LDK-së

**Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, nuk e ka mohuar mundësinë e rikandidimit për kryetar të partisë edhe për një mandat tjetër. Ai ka thënë se për këtë çështje do të deklarohet kur të vijë koha, para mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor të LDK-së. Mustafa ka thënë se zyrtarisht deri më tani nuk ka asnjë kandidat për të parin e partisë. Sipas tij, LDK-ja është unike dhe ambicie për kryetar mund të ketë çdo njëri**

EPOKA E RE — Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 MARS - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të mërkurën as nuk e ka pohuar dhe as nuk e ka mohuar se do të jetë sërish kandidat për kryetar të partisë. Ai ka thënë se për këtë çështje do të deklarohet kur të vijë koha, para mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor të LDK-së. "Në këtë fazë jemi të përqendruar në zgjedhjet nëpër nëndegë dhe degë. Kur ta kemi Kuvendin e LDK-së gati dhe kur të mbërrijmë tek ura, atëherë do të bisedojmë për kryetarin e LDK-së. Do t'i japim mundësi çdonjërit që pretendon dhe që e sheh veten të gatshëm ta marrë drejtimin e LDK-së. Kur vijmë te koha, kur ne duhet të mendojmë për kandidatët, atëherë do të ulemi si LDK, do ta shqyrtojmë situatën dhe do të ofrojmë hapësirë për të gjithë. LDK-ja është unike. Ambicie për kryetar mund të ketë çdo njëri dhe kur të mbërrijmë aty flasim", ka deklaruar Mustafa në një konferencë për medie të mbajtur pas takimit të Kryesisë së LDK-së me kryetarët e degëve.

Pavarësisht prej deklarimeve në opinion, Mustafa ka thënë se deri më tani nuk ka kandidatura zyrtare për kryetar të LDK-së. "Për kandidat nuk kemi biseduar dhe nuk do të bisedojmë derisa të përfundohet procesi. Nuk kemi kandidime zyrtare për kryetar të LDK-së, por kemi deklarime të ndryshme nëpër medie", ka thënë ai.

Lideri i LDK-së, teksa ka shpjeguar procedurat e zgjedhjes së kryetarit të ri, ka thënë se një kandidat për t'i hyrë garës për kreun e partisë duhet të marrë 50 për qind +1 prej votave të përgjithshme të Kuvendit Zgjedhor të LDK-së, skenar ky që në zgjedhjet e kaluara pati lënë jashtë garës kundërkandidaten e Mustafës, deputeten Vjosa Osmani. Po ashtu, Mustafa ka mohuar mundësinë e zgjedhjes së kryetarit të LDK-së përmes një marrëveshje politike siç kishte propozuar nënkryetari i partisë, Lutfi Haziri. Ai ka thënë se në këto zgjedhje do të bëjnë përpjekje maksimale për të pasur dy kandidatë dhe që votimi të jetë i fshehtë ashtu siç parashihet në statutin e LDK-së. "Jemi përcaktuar tash dhe zgjedhjet t'i bëjmë me vota të fshehta. Prapëseprapë janë kuvendet e degëve dhe nëndegëve që vendosin. Ne do të përpiqemi maksimalisht që të bëhet me votim të fshehtë dhe t'i kemi dy kandidatë. Askujt s'ia mbyllim mundësitë që të vijë në kuvend. Në ato zgjedhje mund të marrë pjesë kushdo, burra dhe gra", është shprehur Mustafa.

## Mustafa: Dialogu Kosovë - Serbi është në qorrsokak

Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të mërkurën ka folur edhe për zhvillimet politike në vend, me ç'rast ka thënë se procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë ka mbetur në qorrsokak. Ai ka përsëritur edhe një herë qëndrimin e LDK-së se është kundër korrigjimit të kufijve dhe asociacionit me kompetenca ekzekutive. "Nuk po shoh ndonjë mundësi që procesi i dialogut të shkojë tani siç po deklarohet. Zgjedhjet në Parlamentin Evropian janë shumë afër. Kushtëzimi me tarifën ka mbetur edhe më tutje dhe në këtë situatë, dialogu është në qorrsokak që duhet të dalë në rrugë dhe duhet të zhvillohet. Si LDK kemi thënë se është më së miri që të shkohet në zgjedhje që të ketë institucione legjitime që përfaqësojnë vendin. Nuk do të lëshojmë pe, nuk do të pajtohemi me korrigjim, ndryshim të kufijve, që në tavolinë të shtrohen çështjet që hapin Deklaratën e shpalljes së Pavarësisë apo asociacion që do të ketë kompetencë të pushtetit lokal apo të tretë", ka deklaruar Mustafa, duke shtuar se Ligji për dialog është kundërkushtetues, prandaj është dërguar në Gjykatën Kushtetuese.

Ndonëse e duan rrëzimin e qeverisë, Mustafa ka thënë se nuk po mund t'i bëjnë numrat për ta bërë një gjë të tillë. "Nuk i kemi numrat për zgjedhje. I kemi krejt nunrat e LDK-së. Edhe Vetëvendosja është deklaruar që i ka numrat. Kurse PSD-ja objektivisht është në pozitë, sepse po i voton të gjitha aktet dhe ka propozuar një platformë skandaloze që ne e kemi dërguar në Kushtetuese. Ne do vazhdojmë të përpiqemi t'i sigurojmë votat. PSD-ja po bën propagandë të ulët sepse nuk mund të bashkëpunojë përditë me kryetarin e Kuvendit, kryeministrin dhe, në fund të thuash, 'po, dua ta rrëzojë qeverinë'", është shprehur Mustafa, duke shtuar se koalicioni qeveritar është i dëmshëm dhe i rrezikshëm për të ardhmen e vendit.

## Ministri Tahiri njofton deputetët për zbatimin e agjendës evropiane

PRISHTINË, 20 MARS (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka raportuar të mërkurën para Komisionit për Integrime Evropiane në Kuvendin e Kosovës lidhur me zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA).

Ministri Tahiri i ka informuar deputetët se janë përfunduar të tri obligimet e lidhura me procesin e ERA-s me hartimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, plotësim-ndryshimin e Ligjit mbi Prokurorinë e Shtetit, si dhe Konceptdokumentin për suspendimin e zyrtarëve publikë në rast të ngritjes së aktakuzës për korrupsion.

Duke folur për përmbushjen e

obligimeve nga PKZMSA-ja, ministri Tahiri ka theksuar se nga 42 masa, Ministria e Drejtësisë ka përfunduar 28 prej tyre, kurse 14 masa janë në proces. Në raport me këto obligime, ministri Tahiri ka potencuar edhe hartimin e Pakos së Ligjeve për Gjyqësorin, ku përfshihen ligjet për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës si dhe ai për gjykatat.

Flet për "Epokën e re", Rexhep Selimi

# Heqja e taksës do ta kthente Kos

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se taksa 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë duhet të qëndrojë. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se heqja e kësaj mase do ta kthente Kosovën në pozicion edhe më të keq sesa që ishte në ditën kur nuk kishte taksë. Selimi ka theksuar se shpeshherë pyetet se a duhet të bjerë qeveria për shkak të taksës por, sipas tij, përgjigja është se ka arsye të tjera pse kjo qeveri duhet të bjerë. "Një ndër arsyet se përse Kosova duhet të shkojë drejt zgjedhjeve është keqqeverisja deri në degradim", ka thënë ai. Selimi ka pohuar se punësimet politike, familjare dhe klanore janë vetëm një nga arsyet e shumta që Kosova nuk e meriton të udhëhiqet nga qeveria aktuale. Në këtë intervistë Selimi ka folur edhe për Ligjin për dialogun me Serbinë, ku thotë se presin që Kushtetuesja ta marrë vendimin e drejtë në mbrojtje të sovranitetit të vendit

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 20 mars** - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se punësimet politike, familjare dhe klanore janë vetëm një nga arsyet e shumta që Kosova nuk e meriton të udhëhiqet nga qeveria aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se sa më shpejt që të shkojmë drejt zgjedhjeve të parakohshme aq më shumë do të shpëtojmë nga ajo që tashme po i shkaktohet Kosovës. "Shpeshherë pyetemi se a duhet të bjerë qeveria për shkak të taksës ndaj Serbisë. Natyrisht se përgjigjja jonë është se ka arsye të tjera pse qeveria duhet të bjerë. Një nder arsyet se përse Kosova duhet të shkojë drejt zgjedhjeve është edhe keqqeverisja deri në degradim", ka thënë Selimi, duke shtuar se shkuarja në zgjedhje të reja dhe ndryshimi edhe i mënyrës së qeverisjes me një frymë tjetër shtetbërëse, është zgjidhja e vetme.

Duke folur për vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës dhe presionit ndërkombëtar për pezullimin e kësaj takse, deputeti Selimi ka thënë se Qeveria e Kosovës do të duhej që ndaj Serbisë të aplikonte reciprocitet të plotë politik, ekonomik dhe tregtar. Sipas tij, taksa do të mund të ishte vetëm një nga veprimet e Kosovës për aplikim të këtij reciprociteti. "Kosova e ka ndërmarrë tashmë veprimin e aplikimit të taksës. Heqja e kësaj mase do ta kthente Kosovën në pozicion edhe më të keq sesa që ishte në ditën kur nuk kishte taksë. Prandaj, pavarësisht prej dilemave të dikujt ose kundërshtimeve, qoftë të Thaçit dhe të Serbisë, taksa duhet të qëndrojë", ka thënë Selimi.

Në këtë intervistë Selimi ka folur edhe për Ligjin për dialogun me Serbinë, ku Lëvizja Vetëvendosje, së bashku me LDK-në, e kanë dërguar në Gjykatën Kushtetuese. Ai ka ritheksuar se Lëvizja Vetëvendosje i kundërshton negociatat me Serbinë si në aspektin politik, po ashtu edhe në atë juridik. Selimi ka thënë se në përputhje me këtë qëndrim kanë kundërshtuar edhe Projektligjin për dialogun të sponsorizuar nga partnerët dhe aleatët e koalicionit qeverisës. "Në kuadër të veprimeve tona, këtë ligj tashmë e kemi dërguar në Gjykatën Kushtetuese për arsye se i njëjti shkel nenet thelbësore të Kushtetutës së Republikës që kanë të bëjnë me sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit. Në ndërkohë, ky ligj krijon një organ jokushtetues siç është i ashtuquajturi delegacioni shtetëror për negociata me Serbinë dhe i njëjti i mbivendoset Kuvendit dhe Qeverisë. Prandaj, të drejtën ekskluzive për politikën e jashtme e ka dhe duhet ta ruajë Qeveria, njëkohësisht Kuvendi që e mbikëqyr atë. Po ashtu, pushteti ka tentuar që këtë ligj t'ua mbivendosin marrëveshjeve ndërkombëtare", ka thënë Selimi. Ai ka theksuar se presin që Kushtetuesja ta marrë vendimin e drejtë në mbrojtje të sovranitetit të vendit.

**"Epoka e re":** *Z. Selimi, Lëvizja Vetëvendosje së bashku me LDK-në e kanë dërguar në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për dialogun me Serbinë. Pse ndërmorët këtë veprim dhe çka nëse Kushtetuesja nuk e merr parasysh kërkesën tuaj?*

**Selimi:** Fillimisht ritheksoj se ne i kundërshtojmë negociatat me Serbinë në aspektin politik dhe në aspektin juridik. Në përputhje me këto qëndrime e kemi kundërshtuar edhe Projektligjin për dialogun të sponsorizuar nga partnerët dhe aleatët e koalicionit qeverisës. Kurse, në kuadër të veprimeve tona, këtë ligj tashmë e kemi dërguar në Gjykatën Kushtetuese për arsye se i njëjti shkel nenet thelbësore të Kushtetutës së Republikës që kanë të bëjnë me sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit. Në ndërkohë, ky ligj krijon një organ jokushtetues siç është i ashtuquajturi delegacioni shtetëror për negociata me Serbinë dhe i njëjti i mbivendoset Kuvendit dhe qeverisë. Prandaj, të drejtën ekskluzive për politikën e

# ovën në pozicion edhe më të keq



jashtme e ka dhe duhet ta ruaj qeveria, njëkohësisht Kuvendi që e mbikëqyr atë. Po ashtu, pushteti ka tentuar që këtë ligj t'ua mbivendosë marrëveshjeve ndërkombëtare. Ne kërkojmë dhe presim që Kushtetuesja ta marrë vendimin e drejtë në mbrojtje të sovranitetit të vendit. Nëse kushtetuesen e mban eventualisht nën kontroll pushteti, këtë kontroll nuk do të mund ta aplikojë ndaj nesh dhe ndaj qytetarëve që janë të gatshëm më shumë se kurrë për protesta edhe më masive, edhe më të vendosura sesa më parë.

**"Epoka e re":** *Pavarësisht prej qëndrimeve të dy subjekteve më të mëdha opozitare, pozita dhe PSD-ja janë të gatshme ta vazhdojnë dialogun me Serbinë. Mund të ketë pasoja vendi nëse nuk arrihet unitet për këtë çështje?*
**Selimi:** Ata nuk do të duhej të vazhdonin me shkeljet e radhës sepse, në ndërkohë, në Gjykatën Kushtetuese kemi kërkuar edhe masën e përkohshme të mosveprimit që ka të bëjë me këtë çështje. Po ashtu, kemi kërkuar edhe seancë dëgjimore publike në Gjykatën Kushtetuese për ballafaqimin e argumenteve juridike në mes të palëve. Pushteti dhe aleatët e tyre në grupin negociator nuk duhet të vazhdojnë me veprime antikushtetuese. Vendi mund të ketë pasoja edhe më të mëdha nëse edhe ne do t'u bashkoheshim atyre që po marrin veprime në dëm të sovranitetit. Pra, është pozitive që nuk ka unitet për veprime negative.

**"Epoka e re":** *Qeveria ndodhet në një presin të vazhdueshëm nga ndërkombëtarët për pezullim të taksës. Tashmë edhe brenda vendit janë shtuar zërat se kjo taksë duhet të pezullohet. Si duhet të veprojë qeveria në këtë rast?*
**Selimi:** Qeveria e Kosovës do të duhej që ndaj Serbisë të aplikonte reciprocitet të plotë politik, ekonomik dhe tregtar. Taksa do të mund të ishte vetëm një nga veprimet e Kosovës në aplikim të këtij reciprociteti. Kosova e ka ndërmarrë tashmë veprimin e aplikimit të taksës. Heqja e kësaj mase do ta kthente Kosovën në pozicion edhe më të keq sesa që ishte në ditën kur nuk kishte taksë. Prandaj, pavarësisht prej dilemave të dikujt ose kundërshtimeve, qoftë të Thaçit dhe të Serbisë, taksa duhet të qëndrojë.

**"Epoka e re":** *Qeveria aktuale së fundi është vënë në thumb të kritikave për punësime politike dhe nepotizëm. Cili është mendimi juaj për këtë çështje?*
**Selimi:** Shpeshherë pyetemi se a duhet të bjerë qeveria për shkak të taksës ndaj Serbisë dhe natyrisht se përgjigjja jonë është se ka arsye të tjera pse Qeveria duhet të bjerë. Një ndër arsyet se përse Kosova duhet të shkojë drejt zgjedhjeve është edhe keqqeverisja deri në degradim. Punësimet politike, familjare dhe klanore janë vetëm një nga arsyet e shumta që Kosova nuk e meriton të udhëhiqet nga një qeveri e tillë. Prandaj sa më shpejt që të shkojmë drejt zgjedhjeve të parakohshme aq më shumë do të shpëtojmë nga ajo që tashmë po i shkaktohet Kosovës.

**"Epoka e re":** *Si mundësi për daljen e vendit nga kjo situatë është përmendur një qeveri gjithëpërfshirëse dhe zgjedhjet e parakohshme. Cila është alternativa më e mirë?*
**Selimi:** Nuk pret puna dhe nuk e kemi komoditetin që të presim duke shpresuar përmirësim të gjendjes përderisa po përshkallëzohet keqqeverisja, nepotizmi, korrupsioni dhe krimi i organizuar. Prandaj, shkuarja në zgjedhje dhe ndryshimi edhe i mënyrës së qeverisjes me një frymë tjetër shtetbërëse, është zgjidhja e vetme. Sa më shpejt aq më mirë. Nga zgjedhjet kanë frikë vetëm ata që qeverisin keq dhe ata që tashmë e dinë se e ardhmja e tyre do të jetë së paku në opozitë. Meqë është kështu, zgjedhjet janë zgjidhja.

# Veseli paralajmëron masa të ashpra ndaj korrupsionit dhe nepotizmit

**Prishtinë, 20 mars (ER)** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të mërkurën se Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) po bën një punë të mirë dhe apolitike, prandaj edhe do të ketë përkrahjen e të gjitha institucioneve. Gjatë një vizite në Agjencinë Kundër Korrupsionit, së bashku me ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri, kryeparlamentari Veseli ka paralajmëruar masa të ashpra ligjore në luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Ai ka thënë se korrupsionit dhe nepotizmit do t'i shkohet deri në fund dhe nuk do të mbetet askush pa u ndëshkuar.
Sipas Veselit, korrupsioni ka filluar të bëhet psikologjik brenda familjeve dhe duke i shkaktuar shtetit krizë të besimit. "Prirjet e sëmura që nuk po ndalen dhe po duan ta vënë në dyshim besimin në shtet, nuk do t'i tolerojmë dhe do t'u përgjigjemi siç duhet. Do të ndërmerren veprime dhe hapa për të ndërtuar politika dhe nxjerrë ligje të ashpra të cilat nuk janë parë asnjëherë në Kosovë", ka theksuar Veseli, duke shtuar se do ketë ndëshkime të ashpra edhe për rastet e fundit që kanë ndodhur me nepotizmin.
Ndërsa ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i ka konsideruar pozitive ndryshimet në Ligjin për deklarimin e pasurisë, në bazë të të cilave është dyfishuar numri i zyrtarëve që do ta deklarojnë pasurinë. "Dyfishimi i kësaj liste do ta rrisë transparencën dhe do ta forcojë llogaridhënien para qytetarëve", ka deklaruar Tahiri. Ndërsa drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka thënë se Kuvendi i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë kanë dhënë kontribut të çmuar për zhvillimin e kësaj agjencie.

# Petroviqi sulmohet nga zyrtarët e Listës Serbe

Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 20 mars** - Kryetari i Partisë së Pavarur Liberale, Sllobodan Petroviq, njëherësh deputet në Kuvendin e Kosovës, është sulmuar fizikisht të mërkurën nga dy persona të afërt me ish-ministrin e Bujqësisë në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rikallo nga Lista Serbe. Në një konferencë të mbajtur për media në hollin e Kuvendit të Kosovës, ai ka thënë se sulmi ndaj tij ka ndodhur në afërsi të ndërtesës së Kuvendit. Petroviqi ka theksuar se në mëngjes ishte mysafir në një emision në RTK, ku kishte shpalosur disa hollësi rreth punës së ish-ministrit Nenad Rikallo çka, sipas tij, mund të ketë qenë motiv i sulmit ndaj tij, pasi sulmuesit, siç ka thënë Petroviq, ishin njerëz të afërt me ish-ministrin Rikallo dhe Listën Serbe.

Petroviqi ka thënë se menjëherë pas sulmit ndaj tij e ka ftuar policinë në vendin e ngjarjes e cila tashmë është e njoftuar me rastin. "Në mëngjes isha mysafir në programin e mëngjesit në RTK. Aty i kam paraqitur disa të dhëna për ish-ministrin e Bujqësisë, Nenad Rikallo. Pastaj kam hyrë në një restorant këtu afër Kuvendit për të pirë kafe me disa miq. Personi që më sulmoi ishte kështilltari i Rikallos, Milan Kostiq, i cili për ne të gjithë nga komuniteti serb është i njohur për të keq, pasi i njëjti në mënyrë të pandërprerë disa vjet me radhë në çdo mënyrë është munduar të më diskreditojë mua dhe partinë që unë e udhëheq, duke shkruar tekste të rrejshme. Kjo nuk i mjaftoi. I njëjti ka kërcënuar edhe njerëzit, sidomos në zgjedhjet e fundit, të cilët kanë votuar partinë Liberale Serbe", u shpreh Petroviqi, duke treguar se Kostiqi i kishte thënë se "do ta thyej kokën" përderisa mbante në dorë një shishe të qelqit.

Petroviqi ka thënë se ky sulm nuk është i rastit dhe se ata nuk mund ta frikësojnë.

"Kjo nuk është e rastit. Ato mendime që i kam thënë edhe publikisht, mund të më sulmojnë edhe fizikisht, edhe të më vrasin, por unë nuk frikësohem", ka thënë Petroviqi. "Ju e dini që në muajt e fundit është bërë një fushatë kundër meje dhe partisë sime për arsye se ka 15 vjet që po e udhëheq një politikë që është e njohur deri më tani për bashkëjetesën dhe tolerancën. I jam drejtuar me letër edhe presidentit të Serbisë, Vuçiq, meqë e dini se ai disa herë e ka përmendur punën time dhe mua duke thënë të pavërteta dhe i kam thënë t'i verifikojë mirë faktet", ka thënë Petroviqi, duke shtuar se askush nuk mund ta detyrojë atë që ta ndryshojë politikën e tij në raport me zhvillimet në Kosovë. "Ajo që dua të them edhe një herë është se nuk ekziston asnjë parti dhe asnjë president që do të më detyrojë mua dhe kolegët e mi partiakë ta ndryshojmë politikën tonë. Nuk ekziston ajo politikë që të më detyrojë që të fjalosem me komshinjtë e mi ose të luftojmë, sepse kjo politikë ka bërë që të bien me qindra mijëra viktima. Dua të jemi pjesë e familjes së madhe evropiane, ku

ka shumë komunitete dhe popuj. Këtë e kemi thënë që nga dita e parë dhe gjersa të ekzistojë partia ime dhe sa të jem gjallë ne do të veprojmë në atë mënyrë", ka deklaruar Petroviq.

Por, në reagimin e Listës Serbe thuhet se Petroviqi i pari e ka goditur me telefonin e vet zyrtarin e Listës Serbe. Sipas Listës Serbe, anëtari i këtij subjekti politik, Millan Kostiq, është sulmuar fizikisht nga deputeti Sllobodan Petroviq në një restorant në Prishtinë. "Ky është një sulm i turpshëm ndaj Kostiqit, të cilin në Kosovë e njohin si një njeri familjar dhe i cili në politikë është përfshirë me kërkesën e bashkëkombësve të tij", thuhet në reagimin e Listës Serbe, e cila e bën fajtor Petroviqin për këtë incident.

Për të njëjtin rast, Policia e Kosovës përmes një komunikate ka sqaruar se rreth orës 10:30, të mërkurën, ka marrë informacionin se në rrugën "Fazli Grajqevci" në Prishtinë, ka ndodhur një mosmarrëveshje në mes të tre personave. "Lidhur me këtë rast, policia ka shoqëruar në stacionin policor dy persona, për të cilët ekziston dyshimi se mund të jenë të përfshirë në rastin në fjalë. Policia ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore me qëllim të zbardhjes së të gjitha rrethanave që kanë të bëjnë me këtë ngjarje. Aktualisht, në koordinim me prokurorin e shtetit, po kryhen veprimet e fazës fillestare hetimore, për të proceduar më tej në fazat e tjera", është theksuar në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Sllobodan Petroviqi është një nga dhjetë deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës. Nëntë deputetët e tjerë nga komuniteti serb i përkasin Listës Serbe.

Sulmin ndaj Petroviqit e ka dënuar presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj).

# Raporti i lumturisë: Kosova në vendin e 46

**Prishtinë, 20 mars** - Sipas Raportit më të ri për Lumturinë në Botë, të lëshuar nga Rrjeti për Zgjidhje të Qëndrueshme Zhvillimore në kuadër të OKB-së, Kosova renditet vendi i 46 më i lumtur në botë. Raporti i Lumturisë Botërore është një studim historik i gjendjes së lumturisë globale që i rendit 156 vende, nisur nga fakti se sa të lumtur janë qytetarët e tyre.

Raporti i sivjetshëm i Lumturisë fokusohet në lumturinë dhe komunitetin: se si lumturia ka evoluar gjatë dhjetëra vjetëve të fundit, me fokus në teknologjitë, normat shoqërore, konfliktet dhe politikat qeveritare që i kanë nxitur këto ndryshime. Kosova në këtë raport renditet si vendi i 46, ndërkaq vendet e tjera të rajonit kanë këtë renditje: Serbia në vendin e 70, Mali i Zi 73, Kroacia 75, Bosnje dhe Hercegovina 78, Maqedonia 84, përderisa Shqipëria në vendin e 107.

Sondazhet janë bërë për periudhën ndërmjet viteve 2016-2018.

Finlanda përsëri është e para, si vendi më i lumtur në botë. Dhjetë vendet e tjera që janë renditur vazhdimisht në mesin e më të lumturve janë: Danimarka, Norvegjia, Islanda, Holanda, Zvicra, Suedia, Zelanda e Re, Kanadaja dhe Austria. ShBA-ja u rendit në vendin e 19, duke rënë një vend nga viti i kaluar.

Ndërkaq në fund të listës së vendeve më të lumtura gjenden: Afganistani në vendin e 154, Republika e Afrikës Qendrore në vendin e 155 dhe Sudani Jugor renditet në vendin e 156.

Dita Ndërkombëtare e Lumturisë shënohet më 20 mars.

# Kryeministri kërkon përkushtim në sistemin e drejtësisë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 20 MARS** - Nën kryesimin e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, është mbajtur të mërkurën takimi i radhës i nivelit të lartë të sundimit të rendit dhe ligjit, në të cilën janë prezantuar të arriturat e fundit nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës. Në këtë takim është diskutuar për rastet e shënjestruara, për zbatimin e tyre, për hapat e ndërmarrë dhe për sfidat, për mosndëshkueshmërinë dhe për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast ka përshëndetur çdo të arritur në vendin tonë, duke thënë se është koha e duhur ta korrektojë secili vetveten, në mënyrë që rendi dhe ligji të jetë më efikas dhe në mënyrë që qytetarët tanë ta rrisin besimin në rend dhe ligj.

Më tej, kryeministri Haradinaj ka theksuar se secili nga pjesa e vet e përgjegjësisë duhet të mendojë për realizimin e objektivave të përcaktuara, për përmirësimin e gjendjes në fushën e sundimit të rendit dhe të ligjit që, sipas kryeministrit Haradinaj, është edhe kërkesë e vazhdueshme e miqve të Kosovës. "Të arrijmë rezultate nga puna jonë e përbashkët. Qasja e ballafaqimit duhet të shfrytëzohet nga të gjithë ne për përmirësimin e gjendjes për të mirën tonë. Të vetëdijshëm se kemi ende punë për të bërë, për të dështuar sa duhet vullnet politik dhe vendosmëri për vendosjen e shtetit ligjor, në etapën para nesh sistemi i drejtësisë duhet të ketë synim parësor përfundimin me sukses të të gjitha rasteve të shënjestruara dhe të luftojë me efikasitet mosndëshkueshmërinë", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka përmendur kodin e ri penal, ligjet komplementare të fushës kundër korrupsionit, si Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligji për Konfiskimin e Pasurisë së fituar me Vepër Penale, duke i cilësuar si ligje të cilat do ta fuqizojnë luftën kundër korrupsionit, rritjen e llogaridhënies dhe integritetin e zyrtarëve publikë.

Ndërsa kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, para të pranishmëve prezantoi rezultatet në trajtimin e lëndëve të shënjestruara që kanë të bëjnë me korrupsionin, korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar, të cilat përzgjidhen nga ekipi i përbashkët ndërinstitucional i udhëhequr nga Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës. "Me urdhër të Prokurorëve të Shtetit janë ndërmarrë masa dhe veprime të cilat kanë rezultuar me zgjidhjen e 75 000 dosjeve penale të natyrave të ndryshme, duke përfshirë edhe krimet e luftës, terrorizmin, trafikimin e narkotikëve, trafikimin e qenieve njerëzore. Shpresoj se me hyrjen në fuqi të ligjit për kompetencat e zgjeruara për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë do të lehtësohet puna e prokurorëve për identifikimin, ngrirjen dhe sekuestrimin e pasurisë", ka thënë Lumezi.

Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka thënë se vitin e kaluar është miratuar udhëzuesi për politika ndëshkimore dhe është themeluar komisioni këshillëdhënës për politika ndëshkimore, të arritura këto të cilat do të ndihmojnë që në të ardhmen veprat kriminale ta marrin dënimin e merituar.

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, ka theksuar se Ligji për Konflikt të Interesit ka filluar së zbatuari, përkundër sfidave dhe se janë 83 mijë zyrtarë që i përgjigjen këtij ligji. Po ashtu, një lajm i mirë është edhe Ligji i Sinjalizuesve, për zbatimin e të cilit ky institucion tashmë ka krijuar mekanizmat përcjellës.

Në këtë takim u kërkua përkushtim më i madh nga bartësit e institucioneve përkatëse dhe një dinamikë e shtuar, në mënyrë që të shënohen rezultatet pozitive për zgjidhjen e lëndëve të grumbulluara dhe të shënjestruara dhe përmirësim të kursit të mosndëshkueshmërisë dhe forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit. Përfaqësuesit institucionalë shprehën gatishmërinë dhe zotimet e tyre që këto raste të kenë prioritet dhe të zgjidhen brenda afateve të parapara dhe fuqizimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në këtë takim ishin të pranishëm edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, Philip Kosnett, përfaqësues i Zyrës së BE-së në Kosovë, Riccardo Serri, shefja e EULEX-it, Alexandra Papadopoulos, dhe përfaqësues të tjerë institucionalë.

# Policia mbylli 22 lokacione ku dyshohet se është zhvilluar prostitucion

Rreth 22 lokale të masazhit janë mbyllur nga Policia e Kosovës në aksionin "Masazha 2019", i organizuar në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, inspektoratin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Administratën Tatimore të Kosovës. Ky aksion ka rezultuar me inspektimin e 48 lokaleve të cilët veprimtari e kanë masazhin

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 20 MARS** - Policia e Kosovës ka njoftuar të mërkurën për mbylljen e 22 lokaleve të masazhit për shkak të parregullsive që mund të lidhen me trafikim dhe prostitucion.

Riza Murati nga Drejtoria për Hetimet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Policinë e Kosovës ka bërë me dije se gjatë vitit 2019 në nëntë aksione policore janë arrestuar 41 persona të përfshirë në këto vepra penale, ndërsa në vitin 2018 ishin arrestuar 44 persona. Ai ka treguar se kjo veprimtari më së shumti ushtrohet në qendra të masazhit, ndaj të cilave janë zhvilluar edhe aksionet e policisë. "Të inspektuara 48 lokale, prej tyre 22 të mbyllura për shkak të parregullsive. Janë hasur duke punuar 211 punëtorë, prej tyre, 180 femra, 31 meshkuj. Shtetas të huaj të hasur duke punuar janë 20, 11 të Shqipërisë, gjashtë të Tajlandës, ka pasur të Italisë, Rumanisë, Gjermanisë. Janë hasur edhe pesë punëtore të gjinisë femërore, nën moshën 18-vjeçare. Kemi pasur dy raste në dy lokacione ku janë arrestuar nëntë persona të dyshuar për veprën penale për prostitucion apo detyrim prostitucioni dhe ofrim të lokaleve për prostitucion. Në total në vitin 2019, raste në sallone masazhi janë 18 persona në tri raste të ndryshme", ka thënë Murati.

Ndërsa drejtori i Inspektoratit në Komunën e Prishtinës, Adonis Tahiri, ka thënë se lokacionet e mbyllura do të gjobiten me shumën prej 1 000 eurosh. "Si rezultat i këtyre aksioneve, mbesin të mbyllura 22 lokale të masazhit deri tash. Drejtoria e Inspeksionit në Komunën e Prishtinës është duke i ndjekur procedurat për secilin rast, me urdhëresat dhe gjobat përkatëse. Kushdo që largon bllombën pa urdhër të inspektorit do të ndiqet penalisht", ka thënë Tahiri.

## Kthimi i fondeve pensionale nga Serbia, i domosdoshëm

**Prishtinë, 20 mars (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e Federatës Sindikale të Pensionistëve, Invalidëve dhe të Moshuarve të Kosovës, të prirë nga kryetari i kësaj federate, Sylejman Metaj. Gjatë këtij takimi Haradinaj dhe Metaj kanë diskutuar për domosdoshmërinë e realizimit të së drejtës legjitime të kthimit të fondeve pensionale nga shteti serb. "Vëmendja për dinjitetin e pensionistëve është detyrë e të gjitha institucioneve të vendit. Në takim me përfaqësuesit e Federatës Sindikale të Pensionistëve, Invalidëve dhe të Moshuarve të Kosovës, prirë nga kryetari Sylejman Metaj, diskutuam për domosdoshmërinë e realizimit të së drejtës legjitime të kthimit të fondeve pensionale nga shteti serb", ka thënë Haradinaj pas takimit.

# Dogana bastis 32 lokacione për luftimin e kontrabandës

**Prishtinë, 20 mars (ER)** - Dogana e Kosovës në orët e para të mëngjesit të ditës së mërkurë ka filluar një aksion të madh në kuadër të përpjekjeve për luftimin e krimit të organizuar dhe kontrabandës. Ky aksion i Doganës është bërë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Operacioni është shtrirë në regjionin e Prishtinës, të Prizrenit, të Mitrovicës, të Gjakovës dhe të Ferizajt. "Në vijim të një hetimi, sipas autorizimit të Prokurorisë Themelore të Prizrenit, Dogana e Kosovës, në bashkëpunim me Policinë, ka ndërmarrë një operacion kontrolli bazuar në urdhëresën e Gjykatës së Prizrenit, në 32 lokacione të ndryshme të vendit. Në kuadër të operacionit do të procedohen për ndalim, sipas urdhrit të prokurorit, pesë persona të dyshimtë, ndërsa që operacioni ka rezultuar me gjetjen e dobive pasurore dhe provave të konsiderueshme si në vijim: 2 milionë copë filtër për duhan, pesë armë të zjarrit pa leje, rreth 1 500 kilogramë duhan i grirë, 237 copë makina për mbushje të filtrave me duhan, dy makina grirëse për duhan, 500 copë letër mbështjellëse të duhanit, 1 200 paketime ambalazhe kartoni për duhan dhe dy automjete", është thënë në njoftimin e Doganës.

# Murtezaj viziton drejtoritë rajonale të ATK-së

**Prishtinë, 20 mars (ER)** - Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka nisur të mërkurën vizitat në drejtoritë rajonale të ATK-së, ku fillimisht ka vizituar Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, drejtoritë rajonale Prishtina 2 dhe Prishtina 3. Në këtë takim drejtori i ATK-së foli për planet e këtij viti, për të cilat ka kërkuar angazhim të vazhdueshëm për arritjen e realizimit të tyre, njëkohësisht ka kërkuar ofrim të shërbimeve kualitative për tatimpaguesit.

Murtezaj ka thënë se Administrata Tatimore e Kosovës është e përkushtuar për trajtimin e barabartë të të gjithë tatimpaguesve. Gjithashtu, ai ka thënë se ATK-ja është e palëkundur në qëndrimet e saj për zbatimin e plotë të legjislacionit tatimor, në mënyrë që të krijojë kushte më të mira për zhvillimin e biznesit në Kosovë.

Ndër të tjera, ai porositi drejtuesit e këtyre drejtorive që të kenë parasysh se efikasiteti dhe angazhimi i pandërprerë janë mënyrat e vetme të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në ndërtimin e shtetit, njëherësh në ngritjen e mirëqenies për të gjithë qytetarët e Kosovës. Këto vizita po realizohen në kuadër të planifikimit të vizitave nëpër drejtoritë rajonale të ATK-së, me qëllim të ngritjes së llogaridhënies dhe efikasitetit.

## Gashi falënderon Japoninë për mbështetjen që po i jep Kosovës në sektorët ekonomikë

**Prishtinë, 20 mars (ER)** - Zëvendësministri i Financave, Fatmir Gashi, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion të lartë nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), i kryesuar nga drejtori i Divizionit për Evropë në JICA, Miyazaki Kiyotaka, me të cilët ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe JICA-së. Me këtë rast, zëvendësministri Gashi ka falënderuar Kiyotakan për bashkëpunimin e deritanishëm dhe për gatishmërinë për ta vazhduar dhe thelluar edhe më tutje këtë bashkëpunim. "Ne i jemi shumë mirënjohës Japonisë për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës që nga përfundimi i luftës e deri më sot. Kjo mbështetje është shtrirë në shumë sektorë ekonomikë dhe shoqërorë të vendit tonë. Jemi shumë të lumtur që kemi mundësi të bashkëpunojmë me shtetin dhe popullin japonez dhe të mësojmë shumë nga përvoja shekullore e tij", ka thënë Gashi.

# BERZh-i ndan 30 milionë euro për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka marrë pjesë të mërkurën në konferencën informuese për lansimin e "Programit për grantet e përputhshme", që është i financuar nga Banka Botërore, e që ka për qëllim bashkëfinancimin me ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe shoqatat e biznesit për fushat e standardizimit dhe certifikimit të produkteve, si dhe për shërbimet e zhvillimit të biznesit

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 20 MARS** - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë ka organizuar të mërkurën konferencën informuese për lansimin e "Programit për grantet e përputhshme", që është i financuar nga Banka Botërore, e që ka për qëllim bashkëfinancimin me ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe shoqatat e biznesit për fushat e standardizimit dhe certifikimit të produkteve, si dhe shërbimet e zhvillimit të biznesit.

Në hapjen e kësaj konference, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka potencuar se Qeveria e Kosovës ka pranuar financim nga Grupi i Bankës Botërore për Projektin e Konkurueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport dhe që Nënkomponenti 1.2 i CERP-it parasheh përkrahjen e bizneseve për ta përmirësuar cilësinë e produktit dhe gatishmërinë për eksport, ku përfshin financimin prej 2.3 milionë eurosh për programin e granteve të përputhshme. Ai ka bërë me dije se qëllimi i këtij programi është mbështetja me bashkëfinancim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme me potencial eksportues për certifikimet dhe standardet e produkteve, si dhe për qasjen në shërbimet për zhvillim të biznesit dhe në trajnime.

Kjo nënkomponentë e projektit CERP, sipas ministri Shala, do ta mbështesë Agjencinë e Investimeve dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për ta zbatuar këtë program.

Ministri Shala ka folur edhe për efektin e këtyre granteve në të ardhmen, ku përmes tyre kompanitë do të ndihmohen për rritjen e tregut, për rritjen e eksportit dhe për zhvillimin e produkteve të reja, si dhe për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, duke ndikuar edhe në profesionalizmin e tyre. "Ky financim do të shërbejë shumë për kompanitë edhe në standardet ISO, ku do ta ulin koston e bizneseve dhe do të kenë efekt në përmirësimin e cilësisë së sigurisë. Po ashtu, standardet ISO i ndihmojnë kompanitë për të hyrë në tregje të reja, duke siguruar përputhshmërinë e produkteve dhe shërbimeve", ka thënë Shala.

Me këtë rast, ai ka falënderuar të gjithë donatorët të cilët po mundësojnë zhvillimin e kompanive tona për të qenë në hap me kohën dhe për të pasur zhvillim të qëndrueshëm.

Në fund, ministri Shala ka shprehur besimin se bizneset tona do ta shfrytëzojnë këtë mundësi të jashtëzakonshme për të përfituar nga mundësitë e këtij granti për t'u zhvilluar dhe që të jenë konkurrente edhe në tregjet e Bashkimit Evropian.

Ky program, i cili u prezantua në Prishtinë, u ofron ndërmarrjeve të pranueshme një paketë me kredi, grante për investime dhe asistencë teknike. 25 milionë euro janë ndarë për dy bankat partnere komerciale, "Bankën për Biznes" dhe "Procredit Bank" në Kosovë dhe do të kombinohen me një paketë të asistencës teknike dhe granteve për investime prej më shumë se 5 milionë eurosh nga BE-ja në kuadër të Instrumentit për Asistencë Para-Anëtarësimit (IPA).

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë përfaqësojnë 99.8 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara dhe gjenerojnë afërsisht 75 për qind të punësimit në vend.

Megjithatë, ato shpesh vuajnë nga mungesa e konkurrueshmërisë dhe e qasjes në financa, dhe kontributi i tyre në eksport është vetëm rreth 5-6 për qind.

Neil Taylor, shefi i BERZh-it për Kosovën, ka theksuar se ky program i ri do ta përmirësojë qasjen e bizneseve të vogla në financimin e nevojshëm. "Kombinimi i financimit dhe i asistencës teknike do t'i shtyjë këto ndërmarrje për ta përmirësuar më tej performancën e tyre. Kemi parë sa i suksesshëm është ky program në vende të tjera dhe ne jemi të kënaqur që i përkrahim edhe NVM-të në Kosovë", ka deklaruar Taylor.

Kurse Luigi Brusa, shef i Seksionit të Bashkëpunimit të Zyrës së BE-së në Kosovë, ka thënë ky program është mundësi e mirë për NVM-të në Kosovë.

# Më 3 prill hapet Panairi i Punës në Prizren

**Prizren, 20 mars (ER)** - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se më 3 prill do të hapet Panairi i Punës në këtë komunë. Sipas njoftimit për media, ky panair do të mbahet në Qendrën Sportive "Sezai Surroi". "Më 3 prill 2019, e mërkurë, në Qendrën Sportive 'Sezai Surroi' në Prizren, mbahet Panairi i Punës. Panairi i Punës organizohet në bashkëpunim ndërmjet Komunës së Prizrenit, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Zyrës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Regjistrimi për punëdhënësit (kompani, organizata) dhe punëkërkuesit ka filluar", ka njoftuar Komuna e Prizrenit, e cila drejtohet nga Mytaher Haskuka.



# Drenasi përfiton nga Japonia grant prej 70 mijë eurosh për mamograf

**Drenas, 20 mars (ER)** - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Kazuyuki Takeuchi, diplomat i Ambasadës Japoneze në Austri, përmes Zyrës Ndërlidhëse nga Qeveria e Japonisë në Kosovë, për furnizimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) me aparatin e mamografit. Në kuadër të kësaj marrëveshje, Komuna e Drenasit, përkatësisht QKMF-ja, është fituese e grantit për mamografin i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve. Vlera e grantit për mamografin është rreth 70 mijë euro, ndërsa implementimin e projektit do ta realizojë operatori ekonomik "Medical Group" që, sipas marrëveshjes, brenda 60 ditësh do ta bëjë furnizimin e aparatit të mamografisë.

# Komuna e Gjilanit dhe MTI-ja konfirmojnë bashkëpunimin për zonën ekonomike

**Gjilan, 20 mars (ER)** - Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, me bashkëpunëtorët, ka pritur në një takim pune këshilltarin politik të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Enver Hajrullahu, ku bashkërisht kanë konfirmuar angazhimin e plotë të dy institucioneve për themelimin dhe financimin e zonës ekonomike në Gjilan.

Ismajli ka thënë se Gjilani si komuna më e madhe e këtij regjioni ka në planin e vet dinamik themelimin e zonës ekonomike në një hapësirë prej 52 hektarëve dhe me këtë pretendohet që, përpos kushteve më të mira infrastrukturore, të bëhet edhe tërheqja e investitorëve të rinj në drejtim të kësaj pjese të Kosovës. "Është interes i përbashkët i të gjithë neve që të kemi një zonë ekonomike funksionale në kuadër të mbështetjes dhe zhvillimit të sektorit privat, por edhe me qëllim të ndikimit në zbutjen e papunësisë. Planifikimi i komunës është që kjo zonë të ndërtohet në një pozitë strategjike zhvillimore të integruar edhe në autostradën e cila kalon nëpër Gjilan. Komuna ka kapacitete të investojë në infrastrukturën e zonës, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë", ka thënë Ismajli.

Ndërsa këshilltari politik i ministrit të MTI-së, Enver Hajrullahu, ka konfirmuar se kjo ministri do t'i qëndrojë afër Komunës së Gjilanit në këtë investim që ka impakt në zhvillimin ekonomik. Ai ka thënë se sikur në shumë qytete të Kosovës, ku MTI-ja është duke punuar në zonat ekonomike, edhe Gjilani do ta ketë mbështetjen maksimale në këtë projekt të madh që do të jetë me interes për të gjitha komunat e regjionit të Gjilanit, Kumanovës dhe Luginës së Preshevës.

# Begaj premton përkrahje për Shoqatën e të Verbërve të Kosovës

**Malishevë, 20 mars (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur të mërkurën në një takim pune kryetarin e Shoqatës të së Verbërve të Kosovës, Mexhid Foniqi, dhe kryetarin e kësaj shoqate në Malishevë, Isak Krasniqi, me të cilët ka biseduar për problemet me të cilat ballafaqohet kjo shoqatë. Begaj ka thënë se Komuna e Malishevës pa dallim është e interesuar që shoqatave që përfaqësojnë komunitetet e caktuara, brenda mundësive buxhetore, t'i ndihmojë për kryerjen e shërbimeve që ofrojnë, si në këtë rast me Shoqatën e Personave të Verbër. "E kemi obligim t'i përkrahim këto kategori dhe do të bëjmë gjithçka që kemi mundësi në kuadër të mundësive buxhetore", ka thënë Begaj.

# Përballja e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës me Rusinë

Xhavit HALITI

Po bëhen pesë vjet që marrëdhëniet në mes të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Rusisë janë të tensionuara. Shkaku i lindjes së këtij tensionimi ishte aneksimi i Krimesë nga Rusia, që u konsiderua dhe vazhdon të cilësohet nga Këshilli i Evropës si "ilegal dhe në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare". Për këtë arsye APKiE i ndërpreu disa të drejta delegacionit rus, përfshirë të drejtën e votës por, megjithatë, ky delegacion nuk u përjashtua nga Asambleja. Në reagimin ndaj këtyre sanksioneve, Rusia vendosi dhe nuk i dërgoi kredencialet e deputetëve të delegacionit të vet në APKiE për ratifikim në vitet 2016-2018. Ky raport i brishtë disavjeçar është bërë më shqetësues pas sesionit të katërt të rregullt të APKiE në tetor të vitit të kaluar, ku u paraqit një draftrezolutë për ndryshimin e rregullave të brendshme lidhur me kredencialet e delegacioneve të shteteve anëtare si dhe procedurën e votimit.

Diskutimi në seancë për ndryshimet e parashtruara në draftrezolutë nxori në pah dy grupime të kundërta.

Një grupim politik i quajti ndryshimet e propozuara si tendencioze për të rikthyer delegacionin e Rusisë në APKiE, ndërsa grupimi tjetër, kundërshtar i zëshëm i Draftrezolutës, e quajti këtë si"derivat të shantazhit rus". Diskutantë të tjerë pohuan se nuk janë kundër rikthimit të Rusisë në APKiE, por kundërshtojnë ndryshimin e rregullave në shërbim të akomodimit të shteteve të caktuara, që nuk përfillin parimet e përgjithshme të KiE-së.

Asambleja vendosi t'i rikthehet për rishikim Komitetit për Rregulla, për të ridiskutuar Draft-rezolutën në një nga seancat e ardhshme, por ky vendim u përball shumë shpejt me veprimin dhe aktin ligjor të Rusisë, e cila në janar të këtij viti nuk i dërgoi kredencialet e delegacionit parlamentar në Strasburg, në përputhje me rregullat e APKiE-së, sepse Duma Ruse vendosi që edhe për këtë vit delegacioni rus të mos merrte pjesë në punimet e APKiE.

E bëra gjithë këtë parashtrim, jo vetëm për të treguar gjendjen reale të një raporti mes APKiE-së dhe Rusisë, por për të dhënë edhe ndonjë mendim për pozicionin e shtetit tonë, që prej vitesh ka kërkuar anëtarësimin në AP, në këto momente të tensionuara mes palëve "në konflikt". Mosprania apo prania e delegacionit rus në Asamble, ka ndikim në realizimin e synimeve të Kosovës karshi Këshillit të Evropës. Delegacioni rus prej 18 anëtarësh brenda Asamblesë do të bënte gjithçka për të ndaluar çdo iniciativë të Kosovës për të avancuar statusin e saj pranë APKiE-së. Në këto kushte vendi ynë ndodhet në një mëdyshje për të vendosur se cilido të jetë pozicioni ynë zyrtar ndaj Draft-rezolutës së Asamblesë Parlamentare, kur dihet "pesha" e Rusisë në Evropë dhe në Botë. Dihet gjithashtu konfliktualiteti i saj me mbarë Perëndimin për aneksimin e Krimesë dhe raportet me Ukrainën, siç dihet po ashtu, njësimi nga politika dhe diplomacia ruse, i Pavarësisë së Kosovës nga Serbia me shkëputjen e Krimesë nga Ukraina dhe bashkimi i saj me Rusinë.

Rusia dhe Kina janë dy barrierat penguese të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në OKB, sepse kanë të drejtën e vetos. Rusia, që na konsideron të barasvlefshëm me Krimenë, mendoj se ka ndikuar për mosavancimin e statusit të delegacionit të Kosovës pranë APKiE-së.

Mendoj se një Rusi brenda apo jashtë Asamblesë Parlamentare, ka dhe do të ketë dhe në të ardhmen një impakt negativ për avancimin e statusit të Republikës së Kosovës. Pavarësisht disa mendimeve apo shqetësimeve të ndryshme, që, Kosova të jetë e kujdesshme e të mos procedojë në kushtet e një polarizimi me Rusinë, unë mendoj se nuk duhet hezituar por duhet aplikuar për anëtarësimin tonë në APKiE. Kam bindjen se projektdrafti për ndryshimin e rregullave të brendshme të AP-së lidhur me kredencialet e delegacioneve të shteteve anëtare si dhe procedurën e votimit, ndihmojnë që APKiE të jetë më e fuqishme për të bërë më efektive vlerat themelore të demokracisë, të sundimit të ligjit dhe të të drejtave të njeriut.

**(Autori është nënkryetar i Kuvendit dhe kryesues i Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës)**

# Vetëvendosja: Ahmeti nuk i realizoi as 10 për qind të premtimeve

**PRISHTINË, 20 MARS (ER)** - Drejtues të Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë kanë mbajtur të mërkurën një konferencë për medie në lidhje për, siç kanë thënë ata, "dështimin e realizimit të premtimeve të Komunës së Prishtinës me rastin e më shumë se 500 ditëve të qeverisjes së Shpend Ahmetit".

Kryetari i kësaj qendre, Arben Vitia, ka thënë se Shpend Ahmeti nuk i ka realizuar as 10 për qind të premtimeve elektorale. "As 10 për qind të premtimeve nuk janë realizuar, e shumica e tyre as që kanë filluar. Edhe pse shumica e sfidave dhe problemeve që mund të përballet një ekzekutiv në fillimet e veta ishin kaluar dhe u vendosën bazat për një mandat të dytë cilësor, stili i ri i qeverisjes Ahmeti-AAK-AKR rezultoi përfundimisht i dështuar", ka thënë Vitia. Sipas Vitisë, mbi 60 për qind të investimeve kapitale janë të parealizuara. Ai ka thënë se Ahmeti nuk ka arritur të shpenzojë as shumën e mjeteve të bartura nga viti 2017.

Vitia ka thënë se të hyrat, edhe pse nuk do të duhej të ishin për dekor në Komunën e Prishtinës, ato mblidhen kryesisht nga gjobat që u vihen qytetarëve. "Për këto 500 ditë ende nuk është realizuar ende ndonjë park, edhe pse është themeluar Drejtoria e Parqeve që i ka shërbyer vetëm ndarjes së pazareve me partnerët e koalicionit. Është prezantuar plani për mbledhjen e pagesave nga komuna dhe hartimi i një plani të ri për mbledhjen e mbeturinave në qytet, ndërkohë qyteti është gjithandej me mbeturina", ka thënë ai.

Ndërsa deputetja e Vetëvendosjes, Fitore Pacolli, ka folur për mosrealizmin e projekteve, siç është ai për çerdhet publike dhe reformimi i trafikut urban. "Në mandatin e parë, pavarësisht prej pengesave nga qeveria, arritëm ta dizajnojmë e ta zbatojmë për herë të parë modelin e çerdheve me bazë në komunitet. E pilotuam e në fund e replikuam në pesë çerdhe të reja. I bëmë gati për hapje dy çerdhe të tjera: atë në 'Kodër të Trimave' dhe në lagjen 'Tophane'. Çerdhe këto që kishim planifikuar t'i hapim në fund të vitit 2017, ende nuk janë hapur. U bënë më shumë se 15 muaj që ky kryetar ua mohon çerdhen 250 fëmijëve e 30 punëtorëve mundësinë për të punuar. Ndërsa mbi 200 nëna i mbanë të bllokuara në pamundësi për të siguruar një vend të sigurt për fëmijët e tyre që ato ta vazhdojnë punën apo shkollimin", ka thënë Pacolli.

Kurse sa i përket trafikut urban, ajo ka thënë se pjesë e reformës në këtë sektor nuk ka qenë vetëm blerja e autobusëve, por edhe plani i mobilitetit ku përfshihej zhvillimi i një sistemi të integruar të transportit publik etj. "E njëjta gjë ka ndodhur edhe me funksionalizimin e ndërmarrjes 'Prishtina Parking'. Në anën tjetër kemi edhe shkatërrimin e parkut të vetëm që ka Prishtina - parkun 'Gërmia'. Kryetari ka premtuar ndalimin e qarkullimit të veturave në parkun e 'Gërmia', ndërkaq qarkullimi vazhdon", ka thënë Pacolli.

E jashtëzakonshme

# Balenës i gjejnë 40 kilogramë mbetje plastike në stomak

Një balenë është gjetur e ngordhur pasi kishte ngrënë 40 kilogramë mbetje plastike. Balena është gjetur nga aktivistët në brigjet e Filipineve dhe është cilësuar si një nga rastet më të këqija të helmimit. Balena e ngordhur kishte në stomak qese dhe thasë orizi etj.

FOTO E DITES

Një grua e zhvendosur dridhet nga të ftohtit duke qëndruar afër një shtëpie në Beira, Mozambik. /AFP/

E rrallë

# Seanca parlamentare në Zelandën e Re hapet me leximin e Kuranit

Seanca parlamentare në Zelandën e Re është hapur nga një imam mysliman që lexonte Kuranin. Kjo ishte seanca e parë në Parlamentin e Zelandës pas sulmeve terroriste të javës së kaluar në dy xhami që ua morën jetën 50 myslimanëve. Nizam ul Haq Thanvi recitoi vargje të Kuranit në arabisht për viktimat e masakrës të së premtes, që po falnin namazin në çastin e sulmit.

## BARSOLETA E DITËS

**Arsimtari i historisë, i nervozuar me një nxënës që nuk rri qetë, i bërtet:**
**- A e di ti se Hashim Thaçi në moshën tënde ka qenë nxënës i shkëlqyeshëm?**
**Nxënësi ia kthen:**
**- Po a e dini ju se në moshën tuaj ai është bërë kryeministër?**

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 14:00

### "SHEEP AND WOLVES" 3D



I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

### "ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

### "BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

### """SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

PESHORJA
Ditët e turbullta në situatën tuaj me partnerin po mbarojnë dhe më në fund do të dalë dielli. Do të bëni një udhëtim së bashku.

**DEMI**
Shumë prej jush do të arrijnë ta konsolidojnë situatën në ambientin e punës falë bashkëpunimit të planetëve në shenjën tuaj.

**BINJAKËT**
Kritikat që keni bërë për një person të caktuar sot do t'ju kthehen si bumerang. Çdo parashikim juaji do të dalë i gabuar.

**GAFORRJA**
Sot jeni mjaft energjik dhe keni intuitën të gjendeni në vendin e duhur në kohën e duhur. Mos lini t'ju shpëtojë një rast mjaft i mirë për marrëveshje.

**LUANI**
Sot po tregoni një lloj agresiviteti që mund t'i trembë disi personat që ju qëndrojnë pranë. Dikush do të lëndohet nga një batutë e juaja.

**VIRGJËRESHA**
Sot ka ardhur koha t'i mblidhni frytet e sakrificave tuaja kohën e fundit. Me Hënën në shenjë gjithçka do të shkojë vaj.

**PESHORJA**
Ditët e turbullta në situatën tuaj me partnerin po mbarojnë dhe më në fund do të dalë dielli. Do të bëni një udhëtim së bashku.

**AKREPI**
Mund t'u besoni atyre personave që kanë shprehur përkrahje ndaj jush në çështje mjaft delikate. Do të kërkoni një këshillë për një problem personal.



**SHIGJETARI**
Organizojeni më mirë kohën tuaj të lirë ose dikush do të ankohet se nuk po i kushtoni vëmendje. Duhet t'i mbani pranë gjithë njerëzit e dashur.

**BRICJAPI**
Sot duhet të jeni mjaft të përqendruar në çdo aktivitet që zhvilloni. Në fund të ditës do të jeni mjaft të kënaqur me veten.

**UJORI**
Do të donit që të gjithë t'i kishin të qarta gjërat me ju dhe të mos humbni kohë në shpjegime të kota. Me Marsin në shenjë ndiheni nervoz sot.

**PESHQIT**
Nuk ndiheni shumë të dëshiruar nga partneri sot dhe kjo gjë do t'ju ngulitet përgjatë gjithë ditës, pavarësisht se me çfarë do të merreni.

# Mësohet shkaku i vdekjes së Kristoff St. John




Është zbuluar shkaku i vdekjes së Kristoff St. John, që ndërroi jetë muajin e kaluar në moshën 52-vjeçare. Sipas mjekëve, vdekja e tij kishte të bënte me 'sëmundje zemre, e kombinuar me një mbidozë të alkoolit'. Asnjë informacion tjetër nuk është publikuar.

# Channing Tatum nuk njihet me pamjen e re




Channing Tatum duket pothuajse i panjohur me ngjyrën e re të flokëve. Aktori 38-vjeçar ndau me ndjekësit në "Instagram" një fotografi me pamjen e re. Ai bëri një sondazh për të parë nëse po iu pëlqente njerëzve ky ndryshim. "Ide e keqe?", dhe shtoi opsionet po dhe jo.

# Jennifer Lopezi me çantë 100 mijë dollarëshe

Gjatë fundjavës çifti i sapofejuar, Jennifer Lopez dhe Alex Rodriguez, kanë shijuar një darkë në një nga restorantet e njohura të Nju Jorkut. Por këtë herë unaza e fejesës së Lopezit që kushton 1.8 milion dollarë nuk ishte në qendër të vëmendjes, por gjithë vëmendjen këtë herë e mori çanta që këngëtarja kishte zgjedhur.

# Bella dhe Gigi i bëjnë librat aksesorë të vitit 2019

Bella dhe Gigi janë më shumë se vetëm fytyra të bukura. Pas të gjitha, motrat supermodeluese janë fotografuar me së fundi duke mbajtur libra. Anije analoge të informacionit që lidhen zakonisht me njerëz të zgjuar, si Emma Watson. Siç raporton "Vogue", Bella ka rënë në dashuri me "The Outsider" të Stephen King, një triler prej 560 faqesh që ajo po e lexon për një javë.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

TEL: 045 82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | KOSOVË - DANIMARKË | 1X | HOLANDË - BJELLORUSI | 4+ | BELGJIKË - RUSI | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Kosova ndaj Danimarkës për ta dëshmuar forcën

"Dardanët" e trimëruar pas suksesit historik në Ligën e Kosovës dhe përkrahjes së madhe që do të kenë nga tifozët në stadium janë gati të dëshmojnë sonte (e enjte) potencialin e vërtetë ndaj një kundërshtari të fortë siç është Danimarka. Këta të fundit po e vlerësojnë miqësoren ndaj Kosovës si një ndeshje stërvitore

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 20 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e enjte) përballet në miqësore ndaj Danimarkës, e cila zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 19:00. Danimarka është në mesin e dhjetë kombëtareve më të mira në ranglistën e FIFA-s, por kjo nuk i ka frikësuar aspak trajnerin dhe futbollistët e Kosovës të cilët janë të gatshëm që t'i masin forcat me danezët, sidomos pas suksesit historik në Ligën e Kombeve. Trajneri zviceran i "Dardanëve", Bernard Challandes, në konferencën e fundit para ndeshjes, ka thënë se nuk i bie pishman se zgjodhi danezët për kundërshtar kurse, sipas tij, nëse arrihet fitorja ose barazimi, do të ishte një gjë e shkëlqyeshme për Kosovën, por edhe nga humbja do të nxirret një mësim i ri. "Dikush do të mendojë se nuk është ndoshta e udhës që të luajmë kundër një skuadre kaq të fortë para ndeshjes me Bullgarinë, sepse mendojnë se janë shumë të fortë për neve, por dua që në ta shfrytëzojmë rastin për t'u përballur me një kundërshtar të madh. Ndoshta nuk do të kemi mundësinë të mbajmë topin shumë, por edhe mund të humbim por, gjithsesi, edhe kjo do të na ndihmojë neve që të zhvillohem. Nëse fitojmë ose barazojmë është shkëlqyeshëm, nëse humbim, mësojmë diçka të re", ka thënë Challandes.

Trajneri zviceran, duke iu kundërpërgjigjur trajnerit kundërshtar, se kjo ndeshje do të jetë vetëm stërvitje për skuadrën e tij, ka thënë se në futboll nuk ka kundërshtar dhe ndeshje të lehtë. Ndërkohë qendërmbrojtësi Amir Rrahmani ndihet shumë krenar që e përfaqëson Kosovën pasi, sipas tij, çdo fëmijë që fillon të merret me futboll ëndërron që një ditë të luajë për kombëtaren. "Ta përfaqësosh një shtet është ndjenjë shumë e veçantë, privilegj, nuk mund të krahasohet me asgjë tjetër. Çdo fëmijë sapo fillon ta godasë topin e ëndërron kombëtaren", ka thënë Rrahmani, i cili foli edhe për kundërshtarin e Kosovës, Danimarkën.

Mbrojtësi i Dinamo Zagrebit ka thënë se kjo ndeshje është e njëjtë ma ato të kualifikimeve për Kampionatin Botëror. "Danimarka ka një ekip të mirë, është një ndeshje ndryshe nga ato që kemi luajtur në Ligën e Kombeve, por ka një ngjashmëri me ndeshjet për kualifikimet për botëror. Kjo ndeshje është një test për gjithë ekipin dhe duhet ta kalojmë së bashku", ka shtuar Rrahmani. Ndërsa trajneri i Danimarkës, Age Hareide, nuk ka hezituar edhe një herë ta përsërisë deklaratën e tij se ndeshja me Përfaqësuesen e Kosovës është një miqësore për ekipin përfaqësues danez. "Stërvitore apo miqësore? Çka ka kjo rëndësi, njëjtë - do të jetë ndeshje stërvitore", ka deklaruar Hareide. "Jam ballafaquar me Jugosllavinë në karrierën time. Ekipet që kanë dalë nga ai vend janë të mira. Të gjithë dëshirojnë të luajnë futboll. Kosova dëshiron të luajë futboll. Kosova ka mundësi që të shkojë edhe në Kampionatin Evropian. Ne duam të mësoheni që të luajmë me kundërshtarë që mund të ballafaqohemi në të ardhmen. Ishte e mirë që të vinim dhe të luanim futboll këtu. Kemi mundur të luanim me Gjermaninë, por ishte e vështirë para ndeshjes me Zvicrën. Janë kualifikuar për një grup më lart në Ligën e Kombeve. Kanë luajtur mirë dhe luajnë mirë në sulm dhe transformohen shpejt", ka deklaruar trajneri i Danimarkës, i cili ka siguruar tifozët se në fushë do t'i shohin yjet danezë", ka deklaruar trajneri i Danimarkës.

Pas konferencave për medie, të dyja përfaqësueset kanë zhvilluar stërvitjet e fundit para ndeshjes, kurse duhet cekur se dy yjet e Kosovës, Hekuran Kryeziu dhe Benjamin Kololli, janë stërvitur ndaras nga pjesa tjetër e grupit.

Për ndeshjen miqësore për "Epokën e re" ka folur edhe trajneri i njohur në Kosovë, Gani Sejdiu, i cili ka deklaruar: "Ndeshja me Danimarkën është një test i rëndësishëm për përfaqësuesen e Kosovës, pasi është në momentin më të mirë për lojtarët tanë, të cilët do të kenë përballë një kundërshtar të nivelit të lartë. Edhe kundërshtarët në grupin kualifikues që ka Kosova janë të nivelit të lartë sikurse Danimarka dhe kjo ndeshje do t'u shërbejë shumë përfaqësueseve. Ajo që ka rëndësi të madhe në këto çaste është fakti se të gjithë lojtarët e Kosovës po tregojnë formë të lartë nëpër klube. Duhet të besojmë se përfaqësuesja po rritet sikurse edhe lojtarët nëpër klubet dhe ligat ku paraqiten. Duhet të luajnë për fitore, ani pse rezultati nuk është shumë i rëndësishëm, pasi është ndeshje miqësore. Selektori do ta ketë mundësinë që në këtë ndeshje ta përgatisë edhe ndeshjen me Bullgarinë", ka thënë Sejdiu.

# Donjeta Sadikut i mundësohet marrja e bursës olimpike 'Tokio 2020'

**PRISHTINË, 20 MARS** - Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar u ka mundësuar sërish boksierëve ta marrin bursën olimpike për Lojërat Olimpike "Tokio 2020", pas pezullimit që u ishte bërë në vitin e kaluar. Vendimi është marrë pas diskutimeve të Bordi Ekzekutiv të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, të cilët kanë rënë dakord për ta "hequr ngrirjen e financimit të solidaritetit olimpik për sportistët e boksit, me kusht që të mos kërkohen fonde të tjera ose pagesat të mos bëhen përmes Federatës Kombëtare të Boksit". Me këtë rast, boksierja e vetme në listën e bursistëve olimpikë të Komitetit Olimpik të Kosovës është Donjeta Sadiku. Sipas njoftimit të Solidaritetit Olimpik, fondet duhet të shkojnë te sportistja dhe në këtë rast nuk duhet të përfshihet edhe federata. Që prej 3 majit të vitit të kaluar, Sadikut i ishte ndalur Bursa Olimpike nga SO i KON-it për shkak të mospajtimeve që kishte Komiteti Olimpik Ndërkombëtar me Federatën Ndërkombëtare të Boksit (AIBA). Vendimi për të aktivizimin e bursës olimpike të kampiones së Evropës 2016 për të reja, hyn në fuqi prej janarit 2019, të cilin vendim do ta zbatojë KOK-u. Donjeta përfiton 500 dollarë në muaj nga SO i KON-it.

# Llapi shkarkon Rexhepin, Batatina trajner i ri

**PODUJEVË, 20 MARS** - Skuadra e Llapit nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare në "Facebook" ka njoftuar se ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Xhengis Rexhepi. Trajner i ri i kësaj skuadre do të jetë Tahir Batatina, i cili deri tash e ka mbajtur pozitën e drejtorit sportiv. "Klubi i Futbollit 'Llapi' njofton për përfundimin e bashkëpunimit me trajnerin Xhengis Rexhepi. Si pasojë e mungesës së pikëve të parapara në xhirot e luajtura, drejtuesit e klubit dhe Rexhepi kanë ndërprerë bashkëpunimin me marrëveshje të dyanshme. KF Llapi e falënderon Rexhepin për punën profesionale të bërë me klubin gjatë kësaj periudhe dhe i dëshiron suksese në karrierë. Kryetrajner i Llapit do të jetë Tahir Batatina", thuhet në njoftimin e skuadrës së Llapit.

## Ismajli: Mund të arrijmë fitore ndaj Turqisë

**TIRANË, 20 MARS** - Mbrojtësi i Hajduk Splitit, Ardian Ismajli, pritet të jetë titullar ndaj Turqisë. Ai në konferencë për medie nuk e fshehu lumturinë që është ftuar sërish në kombëtaren kuqezi. "Jam i lumtur që ndodhem këtu dhe do të mundohemi t'jua shpërblej. Që kur e kam nisur kam pasur shumë padrejtësi, por ia kam dalë dhe ja ku jam", ka thënë Ismajli.

Në lidhje me kualifikimin në "Euro 2020", Ismajli ka shtuar: "Kemi shumë shanse të kualifikohemi. Franca është ekipi i mirë, por i kemi mundur në të shkuarën. Islandën dhe Turqinë i kemi mundësi t'i mundim dhe të dalim të dytët".

Më tej mbrojtësi foli edhe në lidhje me rivalin e së premtes, Turqinë. "Mbrojtjen nuk e ka të fortë. Në mesfushë dhe sulm ka lojtarë që luajnë me ekipe të forta, por jo për t'iu frikësuar. Besoj se do t'ia arrijmë qëllimit dhe të fitojmë. Nuk është Turqia e dikurshme. Në Turqi i kemi mposhtur me lojë e rezultat", ka deklaruar Ismajli.

## Mezani, trajner i ri i Gjilanit

**GJILAN, 20 MARS** - Skuadra e Gjilanit ka arritur marrëveshje me trajnerin nga Shqipëria, Gentjan Mezani. Klubi nga Anamorava nëpërmjet faqes zyrtare në "Facebook" ka prezantuar trajnerin shqiptar i cili do të jetë pasardhës i Sadat Pajazitit. "Trajneri Mezani punën në shtabin teknik të skuadrës e fillon nga dita e enjte, ku do të startoj me stërvitjet dhe do t'i bashkëngjitet skuadrës në përgatitjet për vazhdimin e kampionatit. Ushtruesi i detyrës së trajnerit, Alban Hyseni, do t'i rikthehet pozicionit të tij të mëparshëm si ndihmës i Mezanit", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

# MKRS-ja, 248 472 euro për basketbollin

**PRISHTINË, 20 MARS** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Federatën e Basketbollit të Kosovës, sipas të cilit memorandum, FBK-ja mbështetet nga MKRS-ja me 248 472 euro. Qëllimi i nënshkrimit të këtij memorandumi është mbështetja financiare e Federatës së Basketbollit për realizimin e synimeve dhe objektivave të saj për periudhën janar-dhjetor 2019, duke zbatuar politikat programore të Ministrisë në fushën e sportit dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sport dhe akteve të tjera nënligjore të përcaktuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

FBK-ja mjetet financiare të pranuara do t'i shfrytëzojë për realizimin e politikave programore për avancimin e sportit femëror, për avancimin e sportit cilësor, për mjekësinë sportive, për zhvillimin e aktiviteteve sportive të karakterit ndërkombëtar brenda dhe jashtë vendit, për aktivitetet për minoritetet dhe sportin shumetnik, për personat me aftësi të kufizuara etj.

"Është kënaqësi e veçantë që jam sot në ambientet e Federatës së Basketbollit, një institucion shumë i rëndësishëm i zhvillimit të sportit. Është fat i mirë që jemi në një fazë shumë të rëndësishme të sukseseve dhe rezultateve që ka pasur kjo federatë dhe basketbolli në Republikën e Kosovës", ka thënë ministri Gashi, i cili ka shtuar se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje bëhet me një vullnet të madh dhe vjen si rezultat i sukseseve që i ka sjellë Kosovës basketbolli, sidomos në fundin e vitit 2018, të cilin ministri tha se e konsideron periudhë historike për basketbollin. "Ne diskutuam edhe disa çështje të rëndësishme që na presin si Ministri e Sportit bashkë me Federatën e Basketbollit në kuptimin e avancimit të infrastrukturës. Është fat i mirë që këtë vit kemi filluar dhe kemi përuruar dy palestra sportive të cilat kanë qenë për vite të papërfunduara dhe tashmë Kosovës ia kemi dhënë njërën prej palestrave më të bukura siç ka qenë ajo e Rahovecit dhe ku u organizua kampionati, po ashtu edhe palestrën e Shtimes. Besoj se për një periudhë të shkurtër do t'i kemi të përfunduara edhe palestrat e tjera", ka deklaruar Gashi, duke premtuar se shumë shpejt do të përfundojë palestra e Istogut, e Skenderajt, e Deçanit dhe e Kaçanikut, kurse shumë shpejt do të fillojnë punimet për palestrën në Dragash. "Kjo bëhet në mënyrë që të gjitha komunave në Kosovë do t'u japim hapësira infrastrukturore për zhvillimin e sportit, e sidomos basketbollit, sport ky i cili i ka sjellë shumë rezultate Kosovës", ka pohuar ministri Gashi.

Ai tha se bashkë me kryetarin u pajtuan për mundësinë e ndërtimit të një palestre të re në Prishtinë, duke thënë se është një projekt kapital i rëndësishëm për basketbollin dhe sportet e tjera. "Aktualisht në Prishtinë janë dy palestra, '1 Tetori' dhe te Pallati i Rinisë, por nuk i plotësojnë kriteret e FIBA-s. Federata e ka marrë përgjegjësinë së bashku me Komunën për sigurimin e parcelës, kurse ne do t'i ndajmë mjetet në mënyrë që, pas rishikimit të buxhetit, në qershor të krijohet mundësia të fillojë", ka shtuar ministri i sportit.

Ndërkaq kryetari i Federatës u shpreh i kënaqur me nënshkrimin e këtij memorandumi. Ai falënderoi ministrin Gashi për përkrahjen e tij të vazhdueshme ndaj sportistëve dhe për avancimin e basketbollit në Kosovë. "Ju siguroj se në tërë këtë punë që po bëhet në Federatën e Basketbollit ju keni vërtet ndikim dhe merita. Shpresoj se zhvillimi i sportit do të përkojë me zhvillimin e Kosovës dhe vitin e ardhshëm do të kemi edhe më shumë mjete në dispozicion për t'i ndihmuar fëmijët tanë, sportistët tanë dhe do të kemi edhe më shumë rezultate. Sivjet kemi edhe një organizim madhor të vajzave U20 të Divizionit B dhe shpresoj se në të ardhmen do të kemi edhe më shumë organizime si ky, por edhe të niveleve më të larta", ka deklaruar Fetahu.

# Pesë skuadra sigurojnë 'play-off'-in, Hardeni vendos rekord në NBA

**ATLANTA, 20 MARS** - Shkon në pesë numri i skuadrave që sigurojnë një vend në çerekfinalet e "play-off"-it në NBA. Në Lindje, pas Milwaukees dhe Torontos, është kualifikuar edhe Philadelphia, që mundi 118-114 Charlotten. Ndeshje me rivalitet dhe emocione, ku të dyja ekipet dueluan deri në fund për fitoren. Katër lojtarë të Philadelphias realizuan mbi 20 pikë (Simmonsi 28 pikë), duke bërë dallimin në fushë. Në sekondat e fundit fiton Brooklyn, që mundi 123-121 Sacramenton, takim ku diferencën e bëri Russelli, autor i 44 pikëve e 12 asistimeve. Në Perëndim, dy skuadrat e kualifikuara janë Golden State dhe Denveri. Kampionët në fuqi të NBA-së mundën 117-107 Minnesotan, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Warriorsit. Më i miri në fushë ishte Curry me 36 pikë, mbështetur edhe nga Thompsoni me 28, raporton "Telesport". Pa probleme fiton edhe skuadra e Houstonit, në vendin e tretë në Perëndim, që mundi 121-105 Atlantan. Skuadra teksane u shkëput në pjesën e dytë dhe triumfoi falë 31 pikëve të Hardenit dhe 26 të Capelas. Hardeni shkruan historinë e NBA-së, pasi bëhet basketbollisti i parë që shënon mbi 30 pikë ndaj të gjitha ekipeve rivale (29) brenda një sezoni. Humbja e katërt radhazi për lakersat, që zyrtarisht është jashtë zonës së "play-off"-it. Kalifornianët u mundën 115-101 nga Milwaukee, ndeshje e dominuar nga vendësit, me Middletonin që realizoi 30 pikë. LeBroni ishte sërish pushim dhe për Lakersin u dallua Pope, autor i 35 pikëve. Fitojnë edhe clippersat, që mundën 115-109 Indianan, takim që afron ekipin tjetër nga Los Anxhelosi me zonën e "play-off"-it. Gallinari me 24 pikë ishte shënuesi më i mirë i ndeshjes.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Charlotte - Philadelphia | 114-118 |
| Atlanta - Houston | 105-121 |
| Milwaukee - Lakers | 115-101 |
| Minnesota - Golden State | 107-117 |
| Sacramento - Brooklyn | 121-123 |
| Clippers - Indiana | 115-109 |

## SHKURT

### Griezmanni dëshiron largimin nga Atletico

Eliminimi i Atletico Madridit nga Liga e Kampionëve ka bërë që Antoine Griezmann ta shprehë dëshirën për largim. Mediumi spanjoll "Sport" raporton se Manchetser Unitedi është favorit për ta transferuar sulmuesin francez. Interesim për Griezmannin kanë shfaqur edhe Barcelona, SPG-ja dhe Bayern Munchen.

### Hamilton: Ferrari do të jetë rival i fortë për Mercedesin

Kampioni i botës në Formula 1, Lewis Hamilton, është i bindur se Ferrari në garat e ardhshme do të përbëjë një kërcënim serioz për ekipin e Mercedesit. Në garën e parë të sezonit në Melburn, Mercedesi fitoi një rezultat të shkëlqyeshëm. Valteri Botas mori një fitore përpara Hamiltonit, duke i sjell skuadrës gjermane pikët maksimale. "Është e qartë se të gjithë jemi të habitur. Askush nuk e priste një fillim të tillë. Sinqerisht, nga analiza që kam paraqitur, kam besuar se ata tani ishin para nesh. Kjo nuk ishte kështu në garë dhe nuk e di se cili ishte problemi i Ferrarit, por jam i sigurt se do të jenë më të fortë në garën tjetër, kështu që duhet të jemi të kujdesshëm", ka thënë Hamilton.

### Porto 'blindon' Casillasin

Iker Casillas do të vazhdojë t'i mbrojë ngjyrat e Portos. Lajmi është bërë me dije nga vetë klubi në një deklaratë zyrtare në "Twitter", ku shkruhet se portieri ka rinovuar kontratën me klubin dhe shoqërohet nga një foto me çastet më të mira të portierit me skuadrën portugeze. Në postimin e klubit nuk bëhet me dije kohëzgjatja e kontratës por, sipas medieve vendëse, ai pritet të jetë i lidhur me klubin deri në 2021-n.

### Reali, 100 milionë euro për Koulibalyn

